



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA**

URDHËR

Nr. 38, datë 18. 02. 2020

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË QENDRËS SË
STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët të jetë, gjithsej, 12 veta.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA